# S'ka festë me 31 Dhjetor

Vëllezër të nderuar! Në këto ditë jemi duke vërejtur lëvizje dhe përgatitje të papara më herët! Njerëzit me vetëdije dhe pavetëdije përgatiten për të festuar vitin e ri. Valle ata e dinë çfarë feste është viti i ri?! Ose edhe pse e dinë nga dobësia e besimit, ata nuk përfillin rregullat islame në këtë drejtim dhe janë dhënë pas epsheve të tyre. Unë e di se shumë herë njerëzit këto raste i festojnë vetëm për tu argëtuar, mirëpo në Islam ashtu siç janë të rregulluara veprat serioze janë të rregulluara edhe lozja dhe argëtimi. Andaj muslimanët duhet tu përmbahen këtyre rregullave nëse dëshirojnë fitoren dhe triumfin në këtë botë dhe lumturinë në ahiret.

**Festat janë pjesë e pandarë e besimit**

Festimi i natës së vitit të ri ndërlidhet ngushtë me lindjen e Isaut, alejhis-selam, sipas të krishterëve. Sipas katolikëve kjo ditë është me 25 dhjetor, kurse sipas ortodoksëve është me 6 janar. Ata kanë të caktuara rituale të veçanta për festimin e kësaj nate. Këtë natë ata e kalojnë nëpër kisha duke u lutur me lutje të posaçme. Festimi i parë i kësaj dite ka ndodhur në vitin 336 pas lindjes së Isaut, alejhis-selam. Pasi që kjo festë në origjinë, edhe ashtu trajtohet deri më sot, është festë fetare dhe e krishterë, ne si muslimanë duhet të dallohemi prej tyre dhe duhet që mos t'iu përngjajmë dhe mos t'i imitojmë ata.

**Ndalohet përngjasimi dhe imitimi i tyre**

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na e ka tërhequr vërejtjen nga imitimi i tyre duke thënë:

Babadimri ishte një prift i cili shpërndante dhurata, duhet të ketë qenë shën Martini apo prift Nikolasi. Sa i përket bredhit besohej se në shtëpinë në të cilën qëndron bredhi natën e shën Janit do të ketë bereqet gjatë vitit dhe do ta ruaj shtëpinë nga të këqijat.
Allahu na ruajt nga paganizma të tilla dhe nga pjesëmarrja në to.

**Burime të ndryshme për të mësuar më shumë për fenë Islame:**

**Adresa në internet:**
www.albislam.com
www.krenaria.com
www.klubistudentor.com
www.islamidhekrishterimi.com
www.ankebut.com
www.burimi.net (për vajza)
www.miresia.com (për fëmijë)

**në anglisht:**
www.islam-guide.com (mrekullitë shkencore të Kur'anit)
www.islaam.com
www.isamicity.com
www.islamworld.net

**Në radio:**
Radio Kosova e lirë (FM 94.2) çdo të martë ora 21:15 ligjëron dr. Shefqet Krasniqi

**Revistat:**
**Mirësia** - revistë mujore për fëmijë. Shpërndahet falas në shoqatën **Shkëlqimi.**
**Albislam** – revistë edukative islame.
**Argumenti** – revistë shkencore për të rritur e sidomos për të rinj. Është e përmuajshme. Mund ta gjeni në shoqatën **Shkëlqimi.**
**Dituria Islame** – shpërndahet nëpër xhami

Shoqata kulturore SHKËLQIMI




Nëse kjo fletë nuk ju duhet më, digjeni mirë dhe mos e hidhni në mbeturina

"Do të pasoni adetet e atyre që kanë genë para jush pëllëmbë pas pëllëmbe, llërë pas llëre, sagë po të hynin ata në vrimë të hardhucës, do ti pasonit". I thamë: kush janë ata, çifutët dhe të krishterët? Tha: "Kush tjetër përpos tyre". (Buhariu dhe Muslimi).
Po ashtu na ka mësuar se ai që i përngjan një populli është sikur ata duke thënë:
"Kush i përngjan një populli ai është prej tyre". (Ebu Davudi, sahih).
Ose në transmetimin tjetër:
"Nuk është prej nesh ai që u përngjanë tjerëve përveç neve. Mos u përngjani çifutëve dhe të krishterëve". (Tirmidhiu, sahih).
Mosbesimtarët mundohen me mish e me shpirt që muslimanët ti imitojnë ata dhe tua dobësojnë besimin dhe sistemin imunitiv që duhet ta kenë, i cili personifikohet në migësinë dhe armiqësinë për hir të All-llahut.

**Konflikti mes të vërtetës dhe të kotës**

Konflikti mes të vërtetës dhe të kotës do të vazhdojë deri sa të vazhdojë ky ruzull tokësor. Qafirat do të mundohen me gjithë potencialin e tyre që muslimanët ti kthejnë në mosbesimtarë, mirëpo pa marrë parasysh metodat që i përdorin dhe mjetet që i shfrytëzojnë, do të mbeten gjithmonë grupe të muslimanëve të përqëndruar në këtë fe. Kjo është edhe një prej qëllimeve të globalizimit. Globalizim të vlerave. Jo të vlerave të mira, të filtruara dhe të selektuara në bazë të dobisë që mund tu sjellin njerëzve, por të selektuara me synim të dominimit të kulturës dhe civilizimit perëndimor.
All-llahu, subhanehu ve teala, e sqaron dhe e shpalos këtë duke thënë:
"Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni sikurse nuk besuan vetë dhe bëheni të njëjtë. Mos zini mig prej tyre...". (Kur'an, En-Nisa: 89).
Andaj edhe na ka mësuar që mos ti marrim ata si mig duke thënë:
"O ju që besuat! Mos zini mig as jehuditë, e as të krishterët. Ata janë mig të njëri-tjetrit. E kush prej jush i migëson ata, ai është prej tyre. Vërtet All-llahu nuk ve në rrugë të drejtë popullin zullumqar". (El-Maide: 51).
"O ju që besuat, mos e zini mik armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri, kur dihet se ata mohuan të vërtetën që u erdhi juve". (El-Mumtehine: 1).
"O ju që besuat, mos i zini për mig të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj, ata nuk pushojnë së vepruari në dëm tuajin, u dëshirojnë çka u mundon juve. Urrejtja kundër jush duket nga gojët e tyre, por ajo që fshehin në gjokset tyre është edhe më e madhe. Ne pra, ua kemi sqaruar faktet nëse ju i kuptoni". (Ali Imran: 118).
Ata gëzohen kur ne i shmangemi rrugës së vërtetë, pasimin e të cilës rrugë e kërkojmë në çdo namaz tonin.
All-llahu thotë:
"Udhëzona (përforcona) në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!". (El-Fatiha: 5-7).
Ne, në vend se të mbetemi të singertë në pasimin e rrugës së drejtë, nga injoranca ose nga endja, kalojmë në rrugën e të devijuarve ose të atyre që kanë merituar hidhërimin e All-llahut, subhanehu ve teala.
Pjesëmarrja në manifestimin e tyre pasqyrohet me këto vepra:

1- Shkëmbimi i urimeve.
2- Dërgimi i kartolinave të urimit.
3- Shkëmbimi i dhuratave për këtë festë.
4- Kremtimi i kësaj feste qoftë me gosti të mbrëmjes ose edhe vetëm me takim çaji.
5- Dhënia e fëmijëve ëmbëlsira ose lojëra për këtë festë.
6- Blerja e paketave të "babadimrit".
7- Lërja e punës dhe mësimit për këto ditë "festive".
8- Pjesëmarrja në programet e ndryshme televizive për këtë festë.
9- Qëndrimi zgjuar gjatë tërë natës së vitit të ri.
10- Pjesëmarrja në festimet që mbahen në hotele dhe kafene të ndryshme.
11- gjuajta me fishekzjarre dhe mjete tjera shpërthyese.
12. Fotografimi rrugëve me personat e veshur si babadimra, etj.

Këto janë disa forma të manifestimit të kremtimit të natës së vitit të ri, ato që nuk i kemi përmendur në këtë shkrim krahasoni me këto vepra që të dini se a janë të ndaluara si këto ose jo. Pastaj nuk dëshiroj të më kalojë parashtrimi i një pyetjes: <u>pse të krishterët nuk e festojnë bajramin tonë së bashku me ne. Vallë a ag mendjelehtë jemi që nuk shohim këtë gjë!</u> (marrë nga www.albislam.com)

Problemi më i madh është me fëmijë. Mundohuni t'i angazhoni ditën e 31 dhjetorit sa më shumë këshstu që natën të flenë më herët. Premtonju se do t'ju bleni shumë gjera me 2 apo 3 janar dhe mbane premtimin. Mundohuni t'i mbani sa më larg televizorit dhe reklamave dhe sa më larg rrugëve në të cilat paraqiten njerëz të veshur si babadimra gjatë këtyre ditëve. Angazhoni gjatë natës së 31 dhjetorit me lexim të ndonjë tregimi të mirë fetarë apo me ndonjë lojë, etj.

Vëllezër dhe motra, bëhuni edhe ju pjesë e shumë familjeve të cilat kanë vite që e kanë ndërprerë festimin e kësaj "feste" sepse tashmë e kanë të ditur se kjo është haram. Numri është në rritje gjithnjë e më shumë e shpresojmë se ndonjë ditë Inshallah kjo gjë as që do të përmendet në vendin tonë.
E lusim All-llahun, subhanehu ve teala, që të na e mësojë fenë tonë, të na e shtojë besimin, ta udhëzojë rininë tonë, të na mundëson xhennetin dhe të na ruajë nga xhehenemi. Amin.

**Njoftime**

Kjo festë e ka prejardhjen nga romakët e vjetër të cilët e kanë adhuruar një idhull (hyjni) të quajtur Jan. Më vonë këtë festë e morën dhe e përvetësuan të krishterët dhe e përafruan me lindjen e Isës a.s. Tek ne këtë festë e sollën komunistët dhe prej atëherë u bë festë "shtetërore".